




Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja
Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development
AGJENCIA E USHQIMIT DHE VETERINARISË
AGENCIJA ZA HRANU I VETERINARSTVO
FOOD AND VETERINARY AGENCY

Ref: AUV, 01/5362025

Datë: 03.07.2025

Në mbështetje të nenit 22 dhe 23 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratën Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/23 Mars 2019), duke u bazuar në nenin 6, paragrafi 2.1, dhe nenin 15, të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, (08 qershor 2020), bazuar në neni 8, paragrafi 8.1, 8.2 dhe Listës së Programit të parë të Ligjit Nr. 2004/21 për Veterinarinë, standardet e Organizatës Botërore për Shëndetin e Kafshëve (ËOAH), Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë, mori këtë:

V E N D I M

PËR SHPALLJEN E ZONËS SË INFEKTUAR NGA SËMUNDJA MURTAJA E RUMINANTËVE - (PPR)

1. Shpallet zona e infektuar në fshatin Landovicë, Komuna e Prizrenit pas shpërthimit me sëmundjen Murtaja e Ruminantëve (PPR) në fermën e deleve e dhive në një rreze prej 3 km përreth saj;
2. Në këtë zonë ndalohet:
 - Çdo lëvizje e kafshëve pa autorizim nga Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë;
 - Tregtimi dhe transporti i produkteve shtazore (qumësht, mish, lesh, etj.) të prejardhura nga kafshët e dyshimta dhe infektuara.
 - Hyrja dhe dalja e mjeteve transportuese dhe personelit pa masa të dezinfektimit.
 - Grumbullimi i kafshëve për treg apo vende tjera.
3. Në zonën e infektuar do të ndërmerren këto masa:

- Mbikëqyrje aktive dhe pasive e të gjitha fermave me kafshë të prekshme nga kjo sëmundje.
- Hulumtim epidemiologjik për përcaktimin e burimit të infeksionit dhe kontakteve të mundshme me kafshët tjera.
- Zbatim i masave të bio-sigurisë dhe dezinfektimit sipas protokolleve.
- Asgjësimi i kafshëve të ngordhura dhe infektuara dhe trajtimi i mbetjeve biologjike të kafshëve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe mbetet në fuqi deri në një vendim tjetër të autoritetit kompetent.

Bekim Hoxha

 Drejtor Ekzekutiv - AUV

Vendimi t'i dërgohet:

- DSHMK,
- Inspektoratit të AUV-së,
- Komunes së Prizrenit,
- Policisë së Kosovës dhe
- Arkivit të AUV-së..